UDHËZIM
Nr. 594, datë 1.8.2019

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së, nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në piken 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.653 (dhjetëmijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 11.190 (njëmbëdhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2019 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2019, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
4. Udhëzimi nr. 626, datë 27.8.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2019.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu